


TRANSPAROMETRI KOMUNAL 2024

Transparenca e **38 Komunave**
të Republikës së Kosovës

Mars, 2025





Instituti Demokratik i Kosovës është degë e
Transparency International për Kosovë

Misioni i KDI-së është mbështetja e
zhvillimit të demokracisë pjesëmarrëse
dhe luftës kundër korrupsion përmes
promovimit të transparencës,
llogaridhënies dhe integritetit në të
gjitha nivelet dhe sektorët e shoqërisë

COPYRIGHT © 2025. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jo-komerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi, është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialet që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rruga Bajram Kelmendi, Nr. 239,
10000, Prishtinë, Kosovë

Tel.: +383 (0)38 248 038

E-mail: info@kdi-kosova.org

Web: www.kdi-kosova.org

Bartësi i hulumtimit: Besnik Ramadanaj

Layout and design: Envision

Realizimi dhe publikimi i këtij raporti është bërë i mundur me përkrahjen e Olof Palme Internacional Center (OPIC). Përmbajtja është përgjegjësi e KDI-së dhe jo domosdoshmërisht paraqesin qëndrimet e donatorit.

TABELA E PËRMBAJTJES

LISTA E SHKURTESAVE	6
QËLLIMI	7
METODOLOGJIA.....	8
LISTA E INDIKATORËVE	10
REZULTATET E TRANSPAROMETRIT 2024.....	12
VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM I TRANSPARENCËS SË KOMUNAVE NË KOSOVË	13
LANSIMI I WEBFAQEVE TË REJA TË KOMUNAVE.....	14
KRAHASIMI I PERFORMANCËS SË TRANSPARENCËS NË MES TË KUVENDEVE KOMUNALE DHE ZYRAVE TË KRYETARIT/ES (DEGËT EKZEKUTIVE) NË NIVEL TË KOSOVËS	16
TË GJETURAT KRYESORE NGA MONITORIMI PËR VITIN 2024.....	17
PESË INDIKATORËT ME REZULTATET MË TË DOBËTA.....	26
TRANSPARENCA BUXHETORE	28
KOMUNAT ME PROGRESIN MË TË MADH NË TRANSPARENCË	29
KOMUNAT ME RËNIEN MË TË MADHE NË TRANSPARENCË.....	30
REKOMANDIMET PËR KOMUNAT	31
REKOMANDIMET PËR AGJENCINË E SHOQËRISË SË INFORMACIONIT (ASHI):.....	32
REKOMANDIMET PËR MINISTRINË E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL (MAPL):.....	32

LISTA E SHKURTESAVE

KDI	Instituti Demokratik i Kosovës
KK	Kuvendi Komunal
KPF	Komiteti për Politikë dhe Financa
ZIE	Zyra për Integritet Evropian
UA	Udhëzimet Administrative
MAP	Ministria e Administratës Publike
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
KAB	Korniza Afatmesme Buxhetore
ASHI	Agjencia e Shoqërisë së Informacionit
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme

FJALË KYÇE:

transparenca, qeverisja lokale, komuna, qasja në informatë, demokratizimi në nivel lokal, kuvendi komunal, llogaridhënia komunale

QËLLIMI

Transparometri Komunal 2024 ka për qëllim të paraqes një pasqyrë të detajuar të nivelit të transparencës në 38 komunat e Kosovës. Nëpërmjet këtij instrumenti të vlerësimit sistematik, KDI tanimë ka arritur ta transformojë kulturën qeverisëse në nivel lokal, duke kontribuar që transparenca dhe qasja në informacion publik të mirëmbahet dhe avancohet në mënyrë progresive nga bartësit e institucioneve lokale. Duke nxitur transparencën dhe informimin e publikut rreth punës dhe aktiviteteve të qeverisjes lokale, krijohen parakushte për kërkim llogaridhënie dhe për pjesëmarrje në vendim-marrje.

Nëpërmjet 48 indikatorëve të Transparometrit, synohet të vlerësohet niveli i transparencës në Komunitet e Kosovës, përkatësisht publikimin e informatave dhe dokumenteve zyrtare për punën e Kuvendit Komunal dhe Zyrës së Kryetarit (ekzekutivit) për secilën komunë.

Transparometri Komunal 2024 është realizuar nga Aleanca Qytetare për Transparencë, pjesë e të cilës janë 12 organizata lokale partnere dhe udhëhiqet nga KDI, duke promovuar kështu aktivizmin qytetar dhe rrjetizimin e shoqërisë civile në monitorim të institucioneve qeverisëse në nivelin lokal. Kjo i jep mundësi qytetarëve të jenë më të informuar dhe të angazhohen aktivisht në proceset e vendimmarrjes dhe kërkim të llogaridhënies.

METODOLOGJIA

Transparometri për vitin 2024 është rezultat i monitorimit dhe vlerësimit të transparencës në institucionet lokale nëpërmjet 48 indikatorëve për periudhën janar – dhjetor 2024. Matjet janë realizuar nga KDI dhe organizatat partnere lokale të AQT, përgjatë periudhës 2 dhjetor 2024 deri më 10 janar 2025. Të dhënat e mbledhura më pas janë analizuar dhe konfirmuar duke marr për bazë publikimin e informatave dhe dokumenteve zyrtare të vitit 2024, konkretisht për periudhën 01.01.2024 – 31.12.2024.

KDI është bazuar në metodologjinë tashmë të konsoliduar të Transparency International, që i referohet matjeve në kuadër të 48 indikatorëve, por dhe përvojës së saj të gjatë në monitorimin e punës së qeverisjes lokale. Të dhënat janë marrë nga webafqet zyrtare të komunave.

Të gjithë 48 indikatorët janë të fokusuar që të matin transparencën në 2 shtylla qenësore të qeverisjes lokale: Kuvendin Komunal dhe Zyrën e Kryetarit/es.

Metodologjia e njëjtë është aplikuar edhe për katër komunat e pjesës veriore: Mitrovica e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan, si dhe komunat më të vogla: Ranillug, Kllokot, Shtërpçë, Novobërdë dhe Partesh. Gjatë periudhës së mbledhjes së të dhënave, uebfaqet zyrtare të komunës së Ranillugut dhe Shtërpçës nuk ka qenë funksionale. Edhe kësaj here është kontaktuar Agjencia e Shoqërisë së Informacionit pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB), KDI nuk ka marrë ndonjë përgjigje për rastin specifik.

Për qëllime analitike, të dhënat dhe rezulatetet e viti 2024, janë krahasuar me ato të vitit 2023 për të 38 komunat që janë monitoruar.

Ndërkohë, gjatë vlerësimit të komunave në fund të vitit 2024, ka filluar edhe procesi i migrimit të të dhënave nga web faqe e vjetra në të reja.

Pjesë e kontributit gjatë monitorimit të komunave kanë qenë edhe OJQ-të lokale partnere të KDI-së nga "Aleanca Qytetare për Transparencë": 1. Mundësia NGO, 2. Polis, 3. AvoNet, 4. Qeliza, 5. Gjethi, 6. Center for Peace and Tolerance, 7. Center for Policies and Advocacy (QPA), 8. OJQ SHL Kosova, 9. Iniciativa Qytetare Skënderaj (IQS), 10. Ekovizioni, 11.NGO Fortesa, 12. Syri i Vizionit.

Gjatë përcaktimit të indikatorëve, monitorimit dhe vlerësimit është përdorur baza ligjore: Ligji Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale; Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë; Ligji Nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike; Ligji Nr. 02/L-37 Për Përdorimin e Gjuhëve; Udhëzimi Administrativ (MPL) NR. 03/2020 Për Administratë të Hapur në Komuna, i cili ka hyrë në fuqi në dhjetor 2023, (me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi administrativ janë shfuqizuar Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr. 03/2020 për Transparencë në Komuna, Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në komuna dhe Udhëzimi Administrativ (MAPL) nr.01/2019 për monitorimin e kuvendeve të komunave përmes pajisjeve të teknologjisë informative "teleprzencave"); Vendimi i Qeverisë 07/87 mbi miratimin e Kartës për Hapjen e të Dhënave; Rregullorja (QRK) nr. 04/2015 për Kodin e Mirësjelljes në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

VLERËSIMI SIPAS PIKËVE

Për secilin nga 48 indikatorët vlerësues, komunat mund të marrin 0 deri në 2 pikë - në varësi të nivelit të informacionit që ato kanë ofruar, qoftë përmes plasimit të informacionit në webafqet zyrtare, qoftë përmes dhënies së përgjigjeve në kërkesat e drejtuara për qasje në informacion.

- 1 Komunit që nuk kanë ofruar asnjë informacion lidhur me një indikator të caktuar janë vlerësuar me 0 pikë
- 2 Kur informacioni ka qenë i pjesshëm, komunat janë vlerësuar me 1 pikë
- 3 Kur informacioni ka qenë i plotë, komunat janë vlerësuar me 2 pikë.

Rezultati maksimal për një komunë për të gjithë 48 indikatorët është 96 pikë. Rezultati minimal për një komunë për të gjithë indikatorët është 0 pikë.

VERIFIKIMI I CILËSISË SË TË DHËNAVE

Mbledhja, dokumentimi, analizimi dhe verifikimi i të dhënave të Transparometrit Komunal 2024, janë zhvilluar përmes një procesi rigoroz që siguron cilësinë dhe vlerësimin e saktë sipas metodologjisë. Ky proces ka përfshirë disa hapa të rëndësishëm:

- 1 Vlerësimi i publikimit të dokumenteve zyrtare: Ky hap përfshinë vlerësimin preliminar të publikimit të dokumenteve zyrtare në webafqet përkatëse përfshirë afatet ligjore të publikimit, në përputhje me kornizën ligjore.
- 2 Verifikimi dhe kontrollimi i të gjeturave: KDI ka verifikuar të dhënat e mbledhura, duke i kontrolluar për të siguruar që vlerësimi është në përputhje me metodologjinë.
- 3 Dërgimi i gjetjeve te komunat për verifikim/validim përfundimtar: Pas përgatitjes së gjetjeve, ato janë dërguar tek komunat, për validim përfundimtar dhe për të mënjeluar ndonjë lëshim teknik. Ky hap ka për qëllim që vlerësimi të konfirmohet përfundimisht.

LISTA E INDIKATORËVE

- 1
- A është e publikuar thirrja për seancën e kuvendit komunal së bashku me rendin e ditës 7 ditë para se të mbahet?
- 2
- A është i bashkangjitur në thirrje materiali përcjellës për seancë të Kuvendit Komunal?
- 3
- A është bërë informimi i qytetarëve për seancat e Kuvendit Komunal në lokacionet e parapara: shpalljet publike në vende të frekuentuara më shumë, mediave vizive dhe elektronike dhe në rrjete sociale?
- 4
- A është e publikuar thirrja për seancën e Komitetit për politikë dhe financa së bashku me rendin e ditës 7 ditë para se të mbahet?
- 5
- A janë mbajtur të gjitha seancat e rregullta të parapara me ligj (10 prej tyre)?
- 6
- A janë mbledhjet e komiteve të përhershme të hapura për publikun?
- 7
- A janë të publikuara në webfaqen e komunës të dhënat (Emri Mbiemri, Data e lindjes, Email, Telefon, Adresa e banimit, subjekti politik) për të gjithë këshilltarët komunal?
- 8
- A ka një historik të shkurtër me të dhënat kryesore në webfaqe që shërben si njoftim me Komunën?
- 9
- A e ka të publikuar Kuvendi Komunal planin e Punës?
- 10
- A ka KK plan të veprimit për Transparencë 2024 dhe a është publik?
- 11
- A janë të publikuara linqe të videove të mbledhjeve të kuvendit pas mbajtjes së tyre?
- 12
- A ka publiku qasje në draft rregulloret e Kuvendit Komunal?
- 13
- A janë publike rregulloret e miratuara të KK?
- 14
- A janë të publikuar procesverbalet e seancave të Kuvendit Komunal dhe rezultatet e votimit të pikave të rendit të ditës?
- 15
- A ka qasje publiku në vendimet e KK?
- 16
- A janë seancat e hapura për publik?
- 17
- A transmetohen seancat e Kuvendit drejtëpërdrejtë, nëse po në cfarë platforme?
- 18
- A e ka thirrë KK në raportim Kryetarin në Kuvend dhe komitete (raporti i punës 2 herë në vit)?
- 19
- A i ka thirrë KK në raportim drejtorët/eshat në Kuvend dhe komitete?
- 20
- A ka mbajtur KK diskutime brenda afateve ligjore mbi shpenzimet tre-mujore në Kuvend?
- 21
- A janë të gjitha dokumentet publike në të gjitha gjuhët zyrtare?

- 22
- A ka mbajtur KK diskutime publike për KAB gjatë vitit 2024?
- 23
- A ka mbajtur Kuvendi Komunal diskutime publike për buxhetin e vitit 2025?
- 24
- A është bërë konsolidimi i bashkësive lokale dhe a ka informata publike rreth tyre?
- 25
- A janë të publikuara detajet biografike të Kryetarit/res (email, nr. kontaktues, biografi etj)?
- 26
- A janë të publikuara detajet biografike të drejtorëve/eshave (email, nr. kontaktues, biografi etj)?
- 27
- A ekzistojnë informata për çështjet që ndërlidhen me integritet në BE dhe ndikimet e procesit në komunë?
- 28
- A janë konkurset e punësimit dhe kriteret e publikuara për qytetarët?
- 29
- A ka koordinator/e për qasje në D.Z si dhe a është publik raporti me numrin e kërkesave dhe trajtimi i tyre?
- 30
- A ekziston një mekanizëm përcjelles për regjistrimin e kërkesave të qytetarëve dhe statutit të kërkesave të tyre (a është publike)?
- 31
- Si qëndron niveli i përgjigjeve për qasje në Dokumente Zyrtare?
- 32
- A është publik plani i punës të Kryetarit/res për vitin 2024?
- 33
- A është uebfaqja e qasshme në të gjitha gjuhët zyrtare të Komunës?
- 34
- A janë vendimet e Kryetarit/res të Komunës publike dhe të qasshme për publikun?
- 35
- A është borxhi publik komunal i publikuar?
- 36
- A është publike lista e pronave të dhëna me qira nga Komuna?
- 37
- A ka të dhëna mbi të hyrat vetanake të Komunës?
- 38
- A është bërë hapja e të dhënave statistikore Open Data?
- 39
- A përdor Komuna rrjete sociale në baza të rregullta?
- 40
- A janë të publikuara kontaktet e zyrtarit/res dhe zyrës për informim?
- 41
- A ka një linjë direkte pa pagesë për qytetarët?
- 42
- A ekziston një listë e hollësishme e shërbimeve që institucionet ofrojnë për publikun?
- 43
- A ka materiale përcjellëse për qytetarët për dëgjimet publike dhe buxhetore?
- 44
- A janë organizuar takimet publike ashtu sic janë të parapara me ligj?
- 45
- A bëhet publikimi i aktiviteteve në ballinën e webfaqes?
- 46
- Sa është numri i dëgjimeve buxhetore të organizuara nga ekzekutivi i komunës për buxhetin e vitit 2025 dhe koha kur janë realizuar?
- 47
- A ka raport ose procesverbal nga dëgjimet buxhetore të organizuara gjatë vitit 2024 dhe a është publik?
- 48
- A është buxheti i komunës për vitin 2024 i publikuar në webfaqen e komunës?

REZULTATET E TRANSPAROMETRIT 2024

Komuna	Pikë	Përqindje
Ferizaj	95	98.96
Gjakovë	95	98.96
Lipjan	95	98.96
Prizren	95	98.96
Drenas	94	97.92
Klinë	94	97.92
Obiliq	93	96.88
Rahovec	93	96.88
Junik	92	95.83
Vushtrri	92	95.83
Pejë	91	95.18
Shtime	90	93.75
Kaçanik	89	92.71
Mitrovicë e Jugut	89	92.71
Han i Elezit	88	91.67
Podujevë	87	90.63
Prishtinë	86	89.58
Suharekë	86	89.58
Dragash	85	88.54
Kamenicë	84	87.50
Malishevë	84	87.50
Skënderaj	84	87.50
Gjilan	81	84.38
Istog	80	83.33
Viti	75	78.13
Deçan	72	75.00
Graçanicë	72	75.00
Partesh	57	59.38
Fushë Kosovë	50	52.08
Mitrovicë e Veriut	33	34.38
Novobërdë	31	32.29
Mamushë	25	26.04
Shtërpçë	25	26.04
Leposaviç	7	7.29
Kllokot	4	4.17
Ranillug	2	2.08
Zveçan	2	2.08
Zubin Potok	0	0.00

VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM I TRANSPARENCËS SË KOMUNAVE NË KOSOVË

Vlerësimi i 38 komunave në raport me përmbushjen e standardeve të transparencës për vitin 2024, ka rezultuar me një përmirësim të lehtë për dallim nga viti 2023. Vlerësimi mesatar për 38 komunat është 68.34 pikë, nga 62.42 pikë sa ishte në vitin 2023. Ngritjes prej 5.92 pikësh i atribuohet një performancë më e mirë e disa komunave, përfshirë atë të Parteshit, Gjilanit, Obiliqit dhe Vitisë. Megjithatë, nëse analizohet në tërësi, ky përmirësim llogaritet mjaft i ulët.




Fig. 1.1 Performanca e transparencës në komuna për vitin 2024 dhe 2023





Fig. 1.2 Tabela krahasuese me pikët e komunave për vitet 2024 - 2023

LANSIMI I WEBFAQEVE TË REJA TË KOMUNAVE

Problemi i funksionimit të webfaqeve të komunave, është tashmë një çështje e kahmotshme me të cilën qytetarët janë përballur ndër vite. KDI, përmes transparometrit, ka adresuar këtë problem gjatë gjithë kohës, dhe vetëm tash në vitin 2025 kemi lansimin e webfaqeve të reja komunale.

Edhe viti 2024, është ballafaquar me këtë problem gjegjësisht mosfunksionimin e plotë të webfaqeve zyrtare. Në fund të viti 2024, të gjitha komunat e Kosovës kanë kaluar në procesin e migrimit të të dhënave në webfaqet zyrtare të reja.

Asociacioni i Komunave të Kosovë në bashkërendim me institucionet përgjegjëse si Agjencinë për Shoqëri të Informacionit (ASHI), Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe me përkrahjen e OSBE-së - Misioni në Kosovë kishte organizuar gjatë nëntorit 2024 një punëtori për webfaqet e reja të Komunave. Zyrtarët Komunal me përfaqësuesit e ASHI-së dhe të Kompanisë implementuese ishin dakorduar që migrimi i të dhënave të bëhet parciaisht për komunat në afatin njëjavor derisa Komunave do të ju ofrohen edhe video sqaruese dhe udhëzuesi për përpunimin e të dhënave. Pas kësaj punëtorie dhe implementimit të të gjitha fazave për të dhënat e migrimit të tyre, brenda muajit dhjetor, pritet të lansohen webfaqet e reja të Komunave të Kosovës¹.



1 ASK - <https://komunat-ks.net/archives/5762?lang=sq>

Sidoqoftë tek në fund të muajit shkurt, fillim të marsit 2025, kemi parë që webfaqet e reja komunale kanë filluar të jenë të qashsme. Në këto webfaqe shihen përmirësime në kapacitetin e tyre, navigim dhe funksionalitet. Megjithatë, është ende herët për të vlerësuar plotësisht funksionimin e tyre. Poashtu procesi i migrimit të të dhënave po vazhdon ende, pasi kemi të bëjmë me numër të konsiderueshëm të arkivës dhe informatave.

Nga testimet tona, është e qartë se struktura dhe organizimi i informacioneve në webfaqe (layout) ndryshon nga një komunë në tjetrën, duke filluar nga organizimi i seksioneve kryesore. Ky mosunifikim i informacioneve krijon sfida për qytetarët, të cilët do ta kishin më të lehtë qasjen në dokumente dhe informata nëse struktura e webfaqeve do të ishte e standardizuar. Unifikimi i informacioneve dhe standardizimi duke filluar nga çështja më bazike sic është emrërtimi i dokumenteve ka qenë një problem i identifikuar ndër vite dhe një kërkesë e jona për tu adresuar pasi që ka paraqitu shumë vështërsi në gjetjen e dokumenteve.

Megjithëse procesi i kalimit në webfaqe të reja është i mirëpritur, kjo gjatë kësaj periudhe ka mundur të ndikojë në rënien e transparencës dhe shkaktimin e problemeve për qytetarët që kanë pasur kërkesa për institucionet komunale.

Komunat e vogla, kryesisht ato të pjesës veriore, si dhe disa edhe nga pjesë të tjera, si Ranillugu, Mamusha, e Shtërpca, vazhdojnë të kenë probleme në ofrimin e qasjes së mjaftueshme për qytetarët në webfaqet e tyre.


Procesi i migrimit të të dhënave dhe funksionalizimi i webfaqeve është realizuar pa transparencë nga Agjencia e Shoqërisë së Informacionit (ASHI) dhe institucionet tjera përgjegjëse. Nuk ka pasur një komunikim zyrtar mbi afatet e migrimit, kohëzgjatjen e procesit dhe publikimin e përmbajtjeve. Veçanërisht kjo ndikon negativisht në transparencë ndaj qytetarëve sidomos sa i përket publikimit të njoftimeve të rëndësishme, konkurseve dhe informacioneve me afate të kufizuara kohore. Po ashtu ende nuk ka një listë me adresat e webfaqeve të reja të komunave.

Institucionet përgjegjëse përfshirë këtu dhe Agjencinë për Shoqëri dhe Informacion (ASHI), nuk ka dhënë informata zyrtare mbi këtë proces të rëndësishëm që impakton informimin e të gjithë qytetarëve të Kosovës.

KRAHASIMI I PERFORMANCËS SË TRANSPARENCËS NË MES TË KUVENDEVE KOMUNALE DHE ZYRAVE TË KRYETARIT/ES (DEGËT EKZEKUTIVE) NË NIVEL TË KOSOVËS

Në kuadër të Transparometrit 2024 është analizuar edhe performanca sa i përket transparencës në nivel të Kuvendeve Komunale dhe Zyrave të Kryetarit/es përkatësisht ekzekutivit. Nga 48 indikatorë, 24 përfshijnë transparencën në Kuvendet Komunale dhe 24 në atë të ekzekutivit.

Sipas indikatorëve që masin transparencën, zyrat e kryetarëve kanë shënuar një epërsi të lehtë krahasuar me Kuvendet Komunale. Sipas këtyre të dhënave, Zyrat e Kryetarëve kanë performuar me 71.56 për qind, derisa Kuvendet Komunale me 71.03 për qind. Krahasuar me vitin 2023, vërehet një përmirësim në të dyja nivelet.



TË GJETURAT KRYESORE NGA MONITORIMI PËR VITIN 2024

- Komunat **kanë lancuar** webfaqet e reja në fillim të vitit 2025.
- Nuk ka pasur **njoftime publike** për qytetarët lidhur me lancimin, afatet kohore të migrimit të informatave, dhe hyrjen në funksion të webfaqeve të reja.
- Nuk ka informata publike për adresat (domain) e reja të webfaqeve të komunave.
- Mungon **struktura unike dhe e standardizuar** e webfaqeve të reja.
- Afër **90%** e komunave nuk ofrojnë qasje të plotë në dokumente në gjuhët zyrtare. Kjo qasje bie ndesh me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve, i cili në nenin 7 thekson se çdo person ka të drejtë të komunikoj dhe të pranojë shërbimet e mundshme dhe dokumentet publike nga institucionet komunale dhe nga zyrtarët në cilëndo gjuhë zyrtare².
- Rreth **40% e komunave** nuk kanë bërë **konsolidimin e bashkësive lokale** dhe nuk kanë informata publike rreth tyre. Ky aspekt tregon mungesën e vullnetit të ekzekutivit komunal për përfshirjen qytetare në institucionet lokale.
- Afër **60%** e komunave **nuk kanë bërë hapjen e plotë të të dhënave**. Ky element pengon të gjithë qytetarët, mediat dhe personat e interesuar për të pasur qasje në dokumente të përpunueshme sikurse buxheti dhe raporte të ndryshme të Komunave.
- Rreth **32%** e komunave **nuk ofrojnë materiale përcjellëse** për qytetarët për dëgjimet publike dhe buxhetore.
- Pas tre vite qeverisjeje, afër **45%** e komunave ende **nuk i kanë të plota të dhënat** për të gjithë këshilltarët komunal, duke penguar qasjen dhe informatat për qytetarët rreth të zgjedhurve të tyre dhe mënyrave të kontaktimit.
- Rreth **32%** e komunave **nuk kanë një linjë telefonike direkte pa pagesë** për qytetarët, një instrument që do të lehtësonte në masë qasjen dhe koston e qytetarëve ndaj komunave për shërbimet e tyre.
- Mbi **30%** e komunave **nuk informojnë, ose fare pak qytetarët për seancat** e Kuvendit Komunal në lokacionet e parapara.
- Rreth **27%** e komunave **nuk e kanë të publikuar borxhin publik komunal**, aspekt ky që institucionet lokale i shmangen obligimeve ligjore për transparencë rreth buxhetit dhe detyrimeve buxhetore.
- Rreth **26%** të komunave **nuk e kanë të publikuar** planin e veprimit për Transparencë. Ky problem tregon për mungesën e vullnetit të institucioneve lokale për hartimin e një plani për ofrimin e qasjes për qytetarët.
- Rreth **22%** e komunave **nuk ofrojnë një listë të hollësishme të shërbimeve** që institucionet ofrojnë për publikun. Për më tepër, një numër i konsiderueshëm i komunave nuk e kanë lehtë të qasshme këtë informatë, duke shkaktuar vështirësi për qasjen e qytetarëve për të kërkuar shërbime të ndryshme.

² Ligji për Përdorimin e Gjuhëve - <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2440>

Kuvendi Komunal

- 1
- 2
- 3
- 4
- 5
- 6
- 7
- 8
- 9
- 10
- 11
- 12
- 13
- 14
- 15

Indikatori	Dragash	Vushtri	Gjakovë	Ferizaj	Graçanicë	Rahovec	Mitrovicë	Prishtinë	Zubin Potok	Shtërpcë	Suharekë	Zveçan	Leposaviq	Mitrovicë Veriore	Gjilan
1A është e publikuar thirrja për seancën e kuvendit komunal së bashku me rendin e ditës 7 ditë para se të mbahet, gjatë vitit 2023?	2	2	2	2	1	2	2	2	0	1	2	0	0	0	2
2A është i bashkangjitur në thirrje materiali përcjellës për seancë të Kuvendit Komunal?	0	2	2	2	0	2	2	2	0	1	2	0	0	0	0
3A është bërë informimi i qytetarëve për seancat e Kuvendit Komunal në lokacionet e parapara: shpalljet publike në vende të frekuentuara më shumë, mediave vizive dhe elektronike dhe në rrjete sociale?	1	2	2	2	2	2	2	0	0	2	2	0	0	0	1
4A është e publikuar thirrja për seancën e Komitetit për politikë dhe financa së bashku me rendin e ditës 7 ditë para se të mbahet?	2	2	2	2	2	2	2	2	0	0	2	0	0	0	2
5A janë mbajtur të gjitha seancat e rregullta të parapara me ligj (10 prej tyre)?	2	2	2	2	2	2	2	2	0	0	2	0	0	1	2
6A janë mbledhjet e komiteteve të përherhshme të hapura për publikun?	2	2	2	2	2	2	2	2	0	0	2	0	0	2	2
7A janë të publikuara në uebfaqen e komunës të dhënat (Emri Mbiemri, Data e lindjes, Email, Telefon, Adresa e banimit, subjekti politik) për të gjithë këshilltarët komunal?	1	2	2	2	2	2	2	2	0	0	1	0	0	0	1
8A ka një historik të shkurtër me të dhënat kryesore në uebfaqe qe shërben si njoftim me Komunën?	2	2	2	2	2	2	2	2	0	0	2	0	0	2	2
9A e ka të publikuar Kuvendi Komunal planin e Punës për vitin 2024?	2	2	2	2	2	2	0	2	0	0	2	0	0	0	0

- 16
- 17
- 18
- 19
- 20
- 21
- 22
- 23
- 24
- 25
- 26
- 27
- 28
- 29
- 30
- 31
- 32
- 33
- 34
- 35
- 36
- 37
- 38

	Kamenicë	Drenas	Istog	Obiliq	Lipjan	Shtime	Podujevë	Novobërdë	Ranillug	Partesh	Kllokot	Viti	Fushë Kosovë	Skënderaj	Malishevë	Prizren	Mamushë	Klinë	Pejë	Deçan	Junik	Kaçanik	Hani I Elezit
	2	2	2	2	2	2	2	1	0	2	1	2	2	2	1	2	1	2	2	2	2	2	2
	2	2	2	2	2	2	2	0	0	0	0	2	0	2	2	2	0	2	2	1	2	2	2
	1	2	2	2	2	2	2	1	0	1	0	2	0	2	2	2	0	1	2	2	2	2	1
	1	2	2	2	2	1	2	0	0	2	0	2	2	2	1	2	0	2	2	2	2	2	2
	2	2	2	2	2	2	2	2	0	2	0	2	2	2	1	2	0	2	2	2	2	2	2
	2	2	2	2	2	2	2	2	0	2	0	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2
	2	1	2	2	2	2	2	0	0	1	0	1	1	2	2	2	1	2	1	2	1	1	1
	2	2	2	2	2	2	2	0	0	2	1	2	0	2	2	2	0	2	2	2	2	2	2
	2	2	2	2	2	2	2	0	0	2	0	2	2	2	2	2	0	2	2	2	2	2	2

10	A ka KK plan të veprimit për Transparencë 2024 dhe a është publik?	1	0	2	2	2	2	2	2	0	2	2	0	0	0	2
11	A janë të publikuara linqe të videove të mbledhjeve të kuvendit pas mbajtjes së tyre?	2	2	2	2	2	2	2	2	0	0	2	0	0	0	2
12	A ka publiku qasje në draft rregullore të Kuvendit Komunal?	2	2	2	2	2	2	2	2	0	0	2	0	0	0	2
13	A janë publike rregulloret e miratuara të KK?	2	2	2	2	2	2	2	2	0	0	2	0	0	2	2
14	A janë të publikuara procesverbale të seancave të Kuvendit Komunal dhe rezultatet e votimit të pikave të rendit të ditës?	2	2	2	2	2	2	2	2	0	1	2	0	0	0	2
15	A ka qasje publiku në vendimet të KK?	2	2	2	2	2	2	2	2	0	2	2	0	0	2	2
16	A janë seancat e hapura për publik?	2	2	2	2	2	2	2	2	0	2	2	0	0	2	2
17	A transmetohet seancat e Kuvendit drejtpërdrejtë, nëse po në çfarë platforme?	2	2	2	2	2	2	2	2	0	1	2	0	0	0	1
18	A e ka thirrë KK në raportim Kryetarin në Kuvend dhe komitete?	2	2	2	2	2	2	2	2	0	0	0	0	0	0	1
19	A e ka thirrë KK në raportim drejtorët/eshat në Kuvend dhe komitete?	2	2	2	2	2	2	2	2	0	0	0	0	0	0	2
20	A ka mbajtur KK diskutime brenda afateve ligjore mbi shpenzimet tre-mujore në Kuvend?	2	2	2	2	2	2	2	2	0	0	2	0	0	1	1
21	A janë të gjitha dokumentet publike në të gjitha gjuhët zyrtare?	2	1	1	1	2	1	1	1	0	1	1	0	0	1	0
22	A ka mbajtur KK diskutime publike për KAB gjatë vitit 2024?	2	2	2	2	2	2	2	2	0	0	2	0	0	1	2
23	A ka mbajtur Kuvendi Komunal diskutime publike për buxhetin e vitit 2025?	2	2	2	2	2	2	2	2	0	0	2	0	0	1	2
24	A është bërë konsolidimi i bashkësive lokale dhe a ka informata publike rreth tyre?	2	2	2	2	0	1	2	1	0	0	2	0	0	0	2

1	2	2	2	2	2	0	0	0	2	0	0	0	2	2	2	0	2	2	0	2	2	2
2	2	2	2	2	2	2	2	0	0	0	0	2	0	2	2	2	0	2	2	0	2	2
2	2	2	2	2	2	2	2	0	0	2	0	2	0	2	2	2	0	2	2	2	2	2
2	2	2	2	2	2	2	2	0	0	0	0	2	2	2	2	2	2	2	2	1	2	2
2	2	2	2	2	2	2	2	2	0	1	0	2	2	2	2	2	1	2	2	2	2	2
2	2	2	2	2	2	2	2	2	0	2	0	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2
2	2	2	2	2	2	2	2	2	0	2	0	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2
2	2	2	2	2	2	2	2	0	0	1	0	2	0	2	2	2	0	2	2	1	2	2
0	2	2	2	2	2	2	2	0	0	0	0	2	2	2	1	2	0	2	2	2	0	2
0	2	0	2	2	2	2	2	0	0	0	0	2	2	2	2	2	0	2	2	2	1	2
2	2	1	2	2	2	2	2	1	0	1	0	2	0	2	2	2	0	2	2	2	2	2
1	1	2	1	1	1	1	1	0	1	0	0	1	1	1	1	1	1	1	0	1	1	0
2	2	2	2	2	2	2	2	0	0	1	0	0	1	1	2	2	0	2	2	1	2	0
2	2	2	2	2	2	2	2	0	1	2	1	2	1	2	2	2	0	2	2	2	1	0
2	2	0	2	2	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	2	2	0	2	2	2	2	2

ZYRA E KRYETARIT/ES																											
25	A janë të publikuara detajet biografike të Kryetarit/res (email, nr. kontaktues, biografi etj)	2	2	2	2	2	2	2	2	0	0	2	0	0	1	2											
26	A janë të publikuara detajet biografike të drejtorëve/eshave (email, nr. kontaktues, biografi etj)	1	2	2	2	1	2	2	2	0	1	2	0	0	1	2											
27	A ekzistojnë informata për çështjet që ndërlidhen me integritet në BE dhe ndikimet e procesit në komunë?	2	2	2	2	0	2	2	2	0	0	2	0	0	0	2											
28	A janë konkurset e punësimit dhe kriteret të publikuara për qytetarët?	2	2	2	2	2	2	2	2	0	2	2	2	2	2	2											
29	A ka koordinator/e për qasje në D.Z si dhe a është publik raporti me numrin e kërkesave dhe trajtimin e tyre?	2	2	2	2	0	2	2	2	0	1	2	0	0	1	2											
30	A ekziston një mekanizëm përcjellës për regjistrimin e kërkesave të qytetarëve dhe statutit të kërkesave të tyre (a është publike)?	2	2	2	2	0	2	2	2	0	2	2	0	0	2	2											
31	Si qëndron niveli i përgjegjëve për qasje në D.Z?	2	2	2	2	2	2	2	2	0	0	2	0	0	0	2											
32	A është publik plani i punës të Kryetarit/res për vitin 2024?	0	2	2	2	0	2	2	0	0	0	2	0	0	0	0											
33	A është uebfaqja e qasshme në të gjitha gjuhët zyrtare të Komunës?	2	1	2	2	2	2	1	2	0	2	1	0	0	2	2											
34	A janë vendimet e Kryetarit/res të Komunës publike dhe të qasshme për publikun?	2	2	2	2	2	2	2	2	0	0	2	0	0	2	1											
35	A është borxhi publik komunal, i publikuar?	2	2	2	2	0	2	2	0	0	0	2	0	0	0	2											
36	A është publike lista e pronave të dhëna me qira nga Komuna?	2	2	2	2	0	2	2	2	0	0	2	0	0	0	2											
37	A ka të dhëna mbi të hyrat vetanake të Komunës?	2	2	2	2	2	2	2	2	0	0	2	0	0	0	2											

38	A është bërë hapja e të dhënave statistikore Open Data?	1	2	2	2	0	1	1	2	0	0	1	0	0	0	1
39	A përdor Komuna rrjete sociale në baza të rregullta?	2	2	2	2	2	2	2	2	0	2	2	0	2	2	2
40	A janë të publikuara kontaktet e zyrtarit/res dhe zyrës për informim?	2	2	2	2	2	2	2	2	0	0	2	0	0	2	2
41	A ka një linjë direkte pa pagesë për qytetarët?	0	2	2	2	0	2	0	2	0	0	0	0	0	0	2
42	A ekziston një listë e hollësishme të shërbimeve që institucionet ofrojnë për publikun?	2	2	2	2	2	2	2	2	0	0	2	0	0	0	2
43	A ka materiale përcjellëse për qytetarët për dëgjimet publike dhe buxhetore?	2	2	2	2	0	2	2	0	0	0	2	0	0	0	2
44	A janë organizuar takimet publike ashtu siç janë të parapara me ligj?	2	2	2	2	2	2	2	2	0	0	2	0	0	0	2
45	A bëhet publikimi i aktiviteteve në ballinën e uebfaqes?	2	2	2	2	2	2	2	2	0	2	2	0	1	2	2
46	A janë organizuar dëgjime buxhetore me qytetarë nga ekzekutivi i komunës për buxhetin e vitit 2025, para afatit të dorëzimit të buxhetit?	2	2	2	2	2	2	2	2	0	0	2	0	1	1	2
47	A ka raport ose procesverbal nga dëgjimet buxhetore të organizuara gjatë vitit 2024 dhe a është publik.	2	2	2	2	2	2	2	2	0	0	2	0	0	0	2
48	A është buxheti i komunës për vitin 2024 i publikuar në uebfaqen e komunës.	2	2	2	2	2	2	2	2	0	0	2	0	1	0	2

TOTALI	85	92	95	95	72	93	89	86	0	25	86	2	7	33	81
--------	----	----	----	----	----	----	----	----	---	----	----	---	---	----	----

	1	2	1	1	2	1	1	0	0	0	0	2	0	1	0	2	0	2	2	0	2	2	2
	2	2	2	2	2	2	2	2	0	2	0	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2
	2	2	2	2	2	2	2	0	0	2	0	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2
	2	2	0	2	2	2	2	0	0	0	0	2	0	2	2	2	0	2	2	0	2	2	2
	2	2	2	2	2	2	2	0	0	2	0	1	0	2	2	2	0	2	2	2	2	2	2
	2	2	0	2	2	2	2	0	0	0	0	0	0	2	2	2	0	2	2	0	2	2	2
	2	2	2	2	2	2	2	0	0	2	0	1	2	2	2	2	0	2	2	2	2	2	2
	2	2	2	2	2	2	2	2	0	2	0	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2
	2	2	2	2	2	2	2	2	0	2	0	2	2	2	2	2	0	2	2	2	2	2	2
	2	2	2	2	2	2	2	2	0	2	0	2	2	2	2	2	0	2	2	2	2	2	2
	2	2	2	2	2	2	2	0	0	1	0	0	0	2	2	2	0	2	2	0	2	2	2
	2	2	2	2	2	2	2	0	2	2	0	2	2	0	2	2	0	2	2	2	2	2	2

84	94	80	93	95	90	87	31	2	57	4	75	50	84	84	95	25	94	91	72	92	89	88
----	----	----	----	----	----	----	----	---	----	---	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----

PESË INDIKATORËT ME REZULTATET MË TË DOBËTA

Me gjithë mangësitë në ofrimin e transparencës së mjaftueshme, komunat për vite me radhë zvarrisin aspekte të njëjta të ofrimit të qasjes për qytetarët. Përkundër ofrimit të rekomandimeve për përmirësim të gjendjes, komunat ngecin kryesisht në çështjet e natyrave të njëjta.

Pesë indikatorët që shfaqin problemet më të mëdha, tre prej tyre përsëriten edhe në vitin 2023. Ndërkohë, dy indikatorë të tjerë paraqiten për herë të parë në vitin 2024. Ky aspket do të jetë pjesë e rekomandimeve në Transparometrën komunal 2024.

Mungesa e të gjitha dokumenteve në të gjitha gjuhët zyrtare, mungesa e konsolidimit të bashkësive lokale dhe informatat publike rreth tyre, si dhe mungesa e hapjes së të dhënave statistikore (Open Data), janë tre indikatorë që vazhdojnë të përsëriten nga viti 2023 në vitin 2024.

Tabela më poshtë paraqet top 5 indikatorët me rezultatet më të dobëta.

Indikatorët	Përqindja e moszbatimit
1. A janë të gjitha dokumentet publike në të gjitha gjuhët zyrtare?	89.47%
2. A është bërë hapja e të dhënave statistikore (Open Data - të dhëna të përpunueshme)?	57.9%
3. A janë të publikuara në webfaqen e komunës të dhënat (Emri Mbiemri, Data e lindjes, Email, Telefon, Adresa e banimit, subjekti politik) për të gjithë këshilltarët komunal?	44.74%
4. A është bërë konsolidimi i bashkësive lokale dhe a ka informata publike rreth tyre?	39.47%
5. A ka materiale përcjellëse për qytetarët për dëgjimet publike dhe buxhetore?	31.58%

KRAHASIMI I REZULTATEVE TË KOMUNAVE NGA VITI 2023 NË VITIN 2024

Komuna	2024	2023	Dallimi në pikë
Ferizaj	95	94	+1
Gjakovë	95	87	+8
Lipjan	95	94	+1
Prizren	95	94	+1
Drenas	94	94	0
Klinë	94	93	+1
Obiliq	93	68	+25
Rahovec	93	92	+1
Junik	92	91	+1
Vushtrri	92	87	+5
Pejë	91	77	+14
Shtime	90	84	+6
Kaçanik	89	89	0
Mitrovicë e Jugut	89	87	+2
Han i Elezit	88	83	+5
Podujevë	87	89	-2
Prishtinë	86	82	+4
Suharekë	86	83	+3
Dragash	85	81	+4
Kamenicë	84	90	-6
Malishevë	84	74	+10
Skënderaj	84	92	-8
Gjilan	81	39	+42
Istog	80	76	+4
Viti	75	53	+22
Deçan	72	64	+8
Graçanicë	72	61	+11
Partesh	57	12	+45
Fushë Kosovë	50	46	+4
Mitrovicë e Veriut	33	13	+20
Novobërd	31	28	+3
Mamushë	25	29	-4
Shtërpçë	25	25	0
Leposaviç	7	2	+5
Klllokot	4	15	-9
Ranillugë	2	n/a	+2
Zveçan	2	2	0

TRANSPARENCA BUXHETORE

Pjesë e transparometrit si instrument matës janë edhe 10 indikatorë që masin performancën dhe transparencën e komunave sa i përket aspekteve buxhetore. Edhe në këtë drejtim, komunat vazhdojnë të shfaqin mangësi dhe mungesë transparence sa i përket aktiviteteve që lidhen me financat dhe buxhetin e tyre. Po ashtu, komunat karakterizohen edhe me mungesë të vullnetit për të publikuar dokumente të rëndësishme që lidhen me buxhetin.

Sa i përket performancës së këtyre indikatorëve, është vërejtur se komunat nuk ofrojnë qasje të mjaftueshme për qytetarët.

Sipas analizimit të të dhënave nga këta indikatorë, komunat më së dobëti performojnë në atë rreth hapjes së të dhënave statistikore me 38.89%, pastaj mungesa e materialeve përcjellëse për qytetarët gjatë dëgjimeve publike buxhetore me 50%, si dhe mungesa e publikimit të borgjit komunal, ku vetëm 55.56% e komunave e bëjnë një gjë të tillë.

Ndërkohë, sa i përket performancës më të mirë tek indikatorët që lidhen me buxhetin dhe financat, komunat më së miri performojnë tek organizimi i dëgjimeve buxhetore në 66.67% të komunave, pastaj mbajtja e diskutimeve publike për buxhetin, si dhe ai për publikimin e buxhetit në 61.11% të komunave.

Indikatorët	Përqindja e zbatimit
1. A ka mbajtur KK diskutime brenda afateve ligjore mbi shpenzimet tre-mujore në Kuvend?	58.33%
2. A ka mbajtur KK diskutime publike për KAB gjatë vitit 2024?	58.33%
3. A ka mbajtur KK diskutime publike për buxhetin e viti 2025 gjatë shtatorit të 2024?	63.89%
4. A është borxhi publik komunal i publikuar?	55.56%
5. A ka të dhëna mbi të hyrat vetanake të Komunës?	58.33%
6. A është bërë hapja e të dhënave statistikore Open Data?	38.89%
7. A ka materiale përcjellëse për qytetarët për dëgjimet publike dhe buxhetore?	50%
8. A janë organizuar dëgjime buxhetore me qytetarë nga ekzekutivi i komunës për buxhetin e vitit 2025 dhe para afatit të dorëzimit të buxhetit?	66.67%
9. A ka raport ose procesverbal nga dëgjimet buxhetore të organizuara në vitin 2024 dhe a është publik.	55.56%
10. A është buxheti i komunës për vitin 2024 i publikuar në webafqen e komunës?	61.11%

KOMUNAT ME PROGRESIN MË TË MADH NË TRANSPARENÇË

Gjatë realizimit të transparometrit 2024 disa komuna kanë shënuar progres në krahasim me vitin 2023 sa i përket transparencës dhe renditjes së përgjithshme. Pesë komuna kanë shënuar një ngritje edhe në renditje. Por ka edhe nga ato që kanë shënuar progres modest. Në total, nga 38 komuna, 28 prej tyre kanë shënuar ngritje të pikëve sipas indikatorëve të Transparometrit Komunal 2024. Ndërkohë, 6 komuna kanë shënuar regres, si dhe 3 sosh kanë arritur pikët e njëjta me vitin 2023.

Rasti i komunave që kanë shënuar progres thelbësor vjen edhe si pasojë e angazhimit edhe të vetë zyrtarëve përgjegjës për komunikim. Në raste të caktuara, në vitin 2023 komunat kishin hezituar edhe të komunikojnë dhe bashkëpunojnë gjatë procesit të validimit të të dhënave. Ndërkohë, në vitin 2024 përvec se kanë përmirësuar performancën, këto komuna kanë përmirësuar edhe nivelin e përgjigjeve në kërkesat për qasje në dokumente publike.

Përveç elementeve të cekura më lartë, duhet theksuar se komunat janë treguar dukshëm më aktive sidomos edhe gjatë fazës së vlerësimit të transparometrit 2024. Angazhimi dhe mobilizimi i zyrtarëve komunal në raport me transparometrën 2024 është inkurajues dhe premtues.

Tabela më poshtë pasqyron dhjetë komunat me progresin më të madh të shënuar në vitin 2024 dhe krahasuar me vitin paraprak.

Komuna	Pikët 2024	Pikët 2023	Dallimi në pikë
Partesh	57	12	+45
Gjilan	81	39	+42
Obiliq	93	68	+25
Viti	75	53	+22
Mitrovicë e Veriut	33	13	+20
Pejë	91	77	+14
Graçanicë	72	61	+11
Malishevë	84	74	+10
Deçan	72	64	+8
Gjakovë	95	87	+8

KOMUNAT ME RËNIEN MË TË MADHE NË TRANSPARENCË

Sipas të dhënave nga vlerësimi i 38 komunave, në vitin 2024, 6 komuna kanë shënuar regres sa i përket pikëve të mbledhura në 48 indikatorët e Transparometrit. Ndërsa, 3 komuna nuk kanë pasur ndryshim të pikëve të vlerësuara në krahasim me vitin 2023. Në total, rreth 23% e komunave nuk kanë shënuar progres sa i përket matjeve nga transparometri 2024.

Përkundër kësaj dukurie, komunat kanë lidhur arsyetimin me problemet teknike të webfaqeve dhe fillimin e procesit të migrimit të të dhënave në webafqet e reja të tyre. Në një masë, arsyetimi mund të vlerësohet objektiv sikur ky proces të kishte marr kohë gjatë gjithë vitit, ndonëse migrimi i të dhënave dhe kalimi në webafqe të reja është zhvilluar nga fundi i vitit.

Tabela më poshtë pasqyron komunat me rënien më të madhe dhe ato që kanë qëndruar njëjtë me vitin 2023.

Komuna	Pikët 2024	Pikët 2023	Dallimi në pikë
Klllokot	4	15	-9
Skenderaj	84	92	-8
Kamenicë	84	90	-6
Mamushë	25	29	-4
Podujevë	87	89	-2
Zubin Potok	0	2	-2

REKOMANDIMET PËR KOMUNAT

- Të njoftohen qytetarët për adresën zyrtare (domain) të webfaqeve të reja të Komunës së tyre;
- Të organizohen dhe publikohen dokumentet sipas seksioneve përkatëse;
- Të emërtohen dokumentet e publikuara sipas përmbajtjes;
- Të publikohen dokumentet si: buxheti vjetor i detajuar, borgji komunal, Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB), publikimi i procesverbaleve për dëgjimet buxhetore dhe KAB;
- Komunat të publikojnë të gjitha dokumentet në të gjitha gjuhët zyrtare;
- Të përfundohet sa më parë konsolidimi i bashkësive lokale dhe të publikohen informatat rreth tyre;
- Komunat të bëjnë hapjen e të dhënave statistikore në të gjitha komunat – për të qenë të dhëna të përpunueshme dhe lehtë të qasshme për qytetarë, media, shoqërinë civile;
- Për të lehtësuar qasjen dhe komunikimin për qytetarët, rekomandohet komunat që të ofrojnë një linjë telefonike direkte pa pagesë dhe të jenë funksionale dhe të qasshme;
- Të publikohen listat e shërbimeve që komunat ofrojnë për qytetarët në një hapësirë lehtë të qasshme për qytetarët;
- Komunat të hartojnë dhe publikojnë planet e veprimit për transparencë;
- Të publikohen borgjet komunale në të gjitha komunat;
- Të informohen qytetarët dhe të ofrohen materialet përcjellëse si për seancat e kuvendit komunal, gjithash-tu edhe në dëgjimet publike dhe buxhetore;
- Të publikohen të dhënat e plota për të gjithë këshilltarët komunal në të gjitha komunat;
- Të publikohen seancat drejtpërdrejt përmes teleprezencës dhe kanaleve zyrtare në media sociale;

REKOMANDIMET PËR AGJENCINË E SHOQËRISË SË INFORMACIONIT (ASHI):

- Të sigurohet transferimi i të gjitha materialeve, të dhënave dhe arkivës në webafqet e reja të komunave sa më shpejt për të garantuar funksionalizim të plotë të tyre, dhe ruajtje të dokumentacionit zyrtar.
- Të adaptohet një strukturë e njëjtë e organizimit të informacionit në webafqet e reja të Komunave.
- Të krijohet një sistem i avancuar kërkimi që mundëson gjetjen e dokumenteve dhe informacionit me shpejtësi.

REKOMANDIMET PËR MINISTRINË E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL (MAPL):

- MAPL, në bashkëpunim me institucionet e tjera përgjegjëse, të krijojë rregullativën e nevojshme, së bashku me manuale dhe udhëzime standarde për të gjitha komunat, për unifikimin dhe standardizimin e publikimit të dokumenteve në webafqet e komunave.

Aleanca Qytetare për Transparencë (AQT):



Aleanca Qytetare për Transparencë (AQT) është themeluar në vitin 2020 dhe ka për synim të avokoj dhe lloboj tek institucionet lokale dhe qendrore në rritjen e transparencës, përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien institucionale. Anëtarët e AQT janë: OJQ Mundësia, OJQ Fortesa, OJQ IQS, OJQ SHIP, OJQ FOJK si dhe KDI. AQT gjatë vitit 2021 është plotësuar edhe Mundësia NGO, 2. Polis, 3. AvoNet, 4. Qeliza, 5. Gjethi, 6. Center for Peace and Tolerance, 7. Center for Policies and Advocacy (QPA), 8. OJQ SHL Kosova, 9. Iniciativa Qytetare Skenderaj (IQS), 10. Ekovizioni, 11. NGO Fortesa, 12. Syri Vizionit.

Ky raport është mundësuar me përkrahjen financiare të:

